



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Prill 2021

Nr: 12

**UDHËZIM**

**PËR**

**ADMINISTRIMIN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE PËRGJATË PROCESIT TË VOTIMIT  
NË QENDRËN E VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË  
DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “b”, “dh”, “n”, e 2, e 105 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

**U D H Ë Z O J :**

1. Komisioni i Qendrës së Votimit administron listën e zgjedhësve në përputhje me përcaktimet e nenit 105 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 18, pika 1, shkronja “b” të vendimit nr. 11 datë 25 mars 2021 “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit” të Komisionit Rregullator.
2. Kryetari i KQV-së, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.
3. Në rast se PEI funksionon zgjedhësi nënshkruan me gjurmë biometrike në pajisjen PEI.
4. Në rast se PEI nuk funksionon zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij.
5. Ngarkohen KZAZ-të dhe Komisionet e Qendrave të Votimit për zbatimin e këtij udhëzimi.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 24 Prill 2021  
Nr. 12

Për administrimin e listës së zgjedhësve përgjatë procesit të votimit në qendrën e votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 21 prill 2021